

VENDIM
Nr. 549, datë 4.9.2024

**PËR PËRDORIMIN E MJETEVE AJRORE PA PILOT NË ADMINISTRIM TË
FORCAVE TË ARMATOSURA NË MBËSHTETJE TË INSTITUCIONEVE
SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr. 7978, datë 26.7.1995, “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI

Përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit për përdorimin e mjeteve ajrore pa pilot në administrim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të institucioneve të tjera shtetërore, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë.

II. PËRKUFIZIME

Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Bashkëpunimi”**, veprimtaria e përbashkët e Ministrisë së Mbrojtjes (Forcave të Armatosura) me një apo më shumë institucione për realizimin e detyrave, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë.

2. **“Fotografim ajror”**, marrja e imazheve fotografike nga sensorët e mjeteve ajrore pa pilot.

3. **“Informacion i klasifikuar”**, çdo dokument ose material, pavarësisht nga forma apo natyra e tij, i përgatitur ose që përgatitet dhe të cilit i është vendosur një nivel i caktuar klasifikimi dhe ruajtjeje, në zbatim të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”.

4. **“Institucione shtetërore”**, ministritë, institucionet në varësi të Kryeministrit dhe agjencie autonome.

5. **“Infrastruktura kritike”**, strukturat fizike, rrjetet dhe pasuritë e tjera, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin ekonomik e social të shoqërisë ose të komunitetit.

6. **“Infrastrukturë kritike me efekt ndërkufitar”**, ajo infrastrukturë kritike, ndërprerja ose shkatërrimi i së cilës do të kishte impakt të rëndësishëm në një ose disa shtete kufitare me Republikën e Shqipërisë. Rëndësia e impaktit duhet të vlerësohet sipas kriterëve ndërsektoriale. Këtu përfshihen efektet që rezultojnë nga varësitë ndërsektoriale në llojet e tjera të infrastrukturës.

7. **“Mbikëqyrje”**, tërësia e veprimeve dhe e mënyrave që përdoren për të ndjekur një punë apo një veprimtari të caktuar.

8. **“Kërkimi”**, veprimi i kryer nga strukturat e ngarkuara me ligj për kërkim-shpëtimin.

9. **“Komandim-kontrolli”**, procesi, nëpërmjet të cilit komandanti ushtarak ushtron autoritetin dhe drejtimin mbi burimet njerëzore dhe materiale.

10. **“Pamjet filmike”**, pamjet e përfituara nga sensorët e mjeteve ajrore pa pilot.

11. **“Procedurë standarde e veprimit (PSV)”**, një procedurë specifike ose një grup udhëzuesish ose procedurash që dokumentojnë një aktivitet ose proces pune që kryhet brenda një situatë ose proces pune për të rritur cilësinë, duke ndjekur një procedurë të standardizuar të punës.

12. **“Strukturat e mjeteve ajrore pa pilot në Forcat e Armatosura”**, strukturat në varësi të Forcës Ajrore dhe të Forcës Tokësore, që kanë në administrim mjetet ajrore pa pilot.

13. **“Sistemi i avionit pa pilot” (UAS) (*unmanned aircraft system*)**, një mjet ajror pa pilot dhe pajisjet për ta kontrolluar atë në distancë.

14. **“Mjet ajror pa pilot” (UAV) (*unmanned aerial vehicle*)**, çdo mjet ajror që operon ose është krijuar për të operuar në mënyrë autonome ose për t’u pilotuar nga distanca pa një pilot në bord.

15. **“Situatë emergjente”**, situata e papritur, e cila shkaktohet nga faktorë të papërcaktuar, që mund të sjellin dëme të menjëhershme për rendin, për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore e mjedisin, dhe kërkon informacion në kohë reale për gjendjen.

16. **“Të dhëna personale”**, çdo informacion për një person fizik i cili është i identifikuar ose i identifikueshëm, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

17. **“Të dhëna gjeohapësinore”**, çdo e dhënë që i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë një vendi ose zone gjeografike të veçantë.

III. BASHKËPUNIMI DHE NDËRVEPRIMI NDËRINSTITUCIONAL

1. Institucionet, që, për përmbushjen e përgjegjësive të tyre ligjore kërkojnë shërbimet e mjeteve ajrore pa pilot të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, janë:

- a) ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë;
- b) ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe institucionet në varësi;
- c) ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural;
- ç) ministria përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin;
- d) Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- dh) Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
- e) Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor;
- ë) Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

2. Shërbimi i mjeteve ajrore pa pilot ofrohet ndaj institucioneve shtetërore, sipas pikës 1 të këtij kreu, vetëm në rastet kur ky shërbim nuk mund të përfitohet në mënyra dhe mjete të tjera.

3. Operimi i mjeteve/sistemit ajror pa pilot kryhet në çdo rast në përputhje me vendimin nr. 593, datë 18.10.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, funksionimin dhe detyrat e Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare dhe rregullat për koordinimin e bashkëpunimit për organizimin e hapësirës ajrore”, nga personeli i kualifikuar dhe i certifikuar në organikë të Forcës Ajrore ose strukturave të tjera të Forcave të Armatosura që kanë në dispozicion mjete ajrore pa pilot, në përputhje me manualët e shfrytëzimit të mjeteve dhe rregulloret e aviacionit ushtarak dhe civil në fuqi.

4. Institucionet shtetërore kanë të drejtë të përdorin imazhet filmike, fotografike dhe të dhënat e tjera të përftuara nga mjetet ajrore pa pilot, në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes, për të përmbushur detyrimet, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore.

5. Për misionet e planifikuara, kërkesa për fluturim e mjeteve ajrore pa pilot bëhet të paktën dy ditë pune para fillimit të detyrës/misionit dhe, në çdo rast, plotësohet formulari i aplikimit sipas procedurave standarde të veprimit.

6. Për misionet e paplanifikuara, kërkesa për fluturim e mjeteve ajrore pa pilot bëhet menjëherë para fillimit të detyrës/misionit dhe i dërgohet Qendrës së Bashkuar Operacionale (QBO) të Forcave të Armatosura dhe, në çdo rast, shoqërohet sa më shpejt të jetë e mundur me formularin e aplikimit.

7. Imazhet filmike, fotografike dhe të dhënat e tjera të përftuara nga sistemi i mjeteve ajrore pa pilot shfaqen në një hapësirë të dedikuar komandim-kontrolli në një nga venddislokimet e Forcave të Armatosura, duke respektuar rregullat e informacionit të klasifikuar dhe të përdorimit të të dhënave personale.

8. Kur kërkohet njohja me informacion të klasifikuar, institucionet shtetërore kërkuese duhet të autorizojnë personel të pajisur me certifikatën e sigurisë, sipas nivelit të kërkuar, për të administruar dhe për të përdoruar të dhënat të përftuara nga sistemi i mjeteve ajrore pa pilot.

9. Institucionet shtetërore, të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, i kërkojnë Ministrisë së Mbrojtjes, mbështetur në planifikimin vjetor ose rast pas rasti, të angazhojë strukturat e mjeteve ajrore pa pilot në administrim të Forcave të Armatosura. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, në varësi të vlerësimit të kapaciteteve në dispozicion, vendos ose jo për angazhim të tyre dhe njoftohet kërkuesi.

10. Strukturat përgjegjëse për administrimin e informacionit të përfituar nga mjetet ajrore pa pilot e vendosin në dispozicion këtë informacion vetëm me kërkesë të institucioneve shtetërore, të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu.

11. Informacioni i përfituar nga mjetet ajrore pa pilot trajtohet nga të gjitha institucionet përfituese, sipas nivelit të klasifikimit të vendosur nga prodhuesi, sipas ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar".

12. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, nëpërmjet QBO-së, është strukturë koordinuese ndërmjet institucioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

13. Shpenzimet financiare për përdorimin e mjeteve ajrore pa pilot në mbështetje të institucioneve të tjera shtetërore mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

14. Në çdo kohë, komandim-kontrolli i strukturave të mjeteve ajrore pa pilot mbetet i pandryshuar.

IV. PËRDORIMI I MJETEVE AJRORE PA PILOT DHE PROCEDURAT E PUNËS

1. Mjetet ajrore pa pilot të Forcave të Armatosura përdoren në mbështetje të institucioneve shtetërore sipas pikës 1, të kreut III, të këtij vendimi, për sigurimin e pamjeve filmike dhe fotografike, me qëllim:

a) mbikëqyrjen e territorit për të zbuluar dhe parandaluar aktivitete të paligjshme, si: kultivimi i bimëve narkotike, kontrabanda, emigracioni i paligjshëm, shkeljet territoriale, si dhe përdorimi i paautorizuar i burimeve ujore;

b) monitorimin e kufijve;

c) monitorimin e vijës bregdetare, ku përfshihet dhe rada portuale, të shtretërve dhe brigjeve të lumenjve, përrenjve, liqeneve, pellgjeve, lagunave dhe ujëmbledhësve natyrorë apo artificialë, ishujve dhe grumbullimeve të rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, tokës së përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit, kur ajo lidhet me tokën, zonave të mbrojtura mjedisore, si dhe venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane;

ç) mbështetjen në reagim të emergjencave civile në raste tërmetesh, uraganesh, përmytyesh dhe zjarresh, duke ofruar vëzhgime ajrore për vlerësim paraprak të dëmeve;

d) monitorimin e vatrave/zonave të zjarrit, për të gjurmuar përparimin e zjarrit dhe për të identifikuar pikat e nxehta;

dh) zhvillimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR) në gjetjen e të mbijetuarve, vlerësimin e dëmtimit të infrastrukturës dhe koordinimin e përpjekjeve të ndihmës, në gjetjen e personave/mjeteve të humbura/zhdukura ose individëve të bllokuar;

e) inspektimin vizual nga ajri të infrastrukturës kritike kombëtare dhe infrastrukturës kritike me efekt ndërkombëtar;

ë) fotografimin ajror të territorit me qëllim krijimin, administrimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit gjeohapësinor për institucionet publike;

f) plotësimin e kërkesave të institucioneve publike për fotografimin ajror, me qëllim krijimin e informacionit gjeohapësinor, i cili administrohet dhe koordinohet nga ASIG-u;

g) kryerjen e studimeve dhe kërkimeve shkencore që ndikojnë pozitivisht në fuqizimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë e të mbrojtjes;

gj) mbështetjen e operacioneve të rëndësishme policore në zbatim të një plani kombëtar veprimi ose strategjie të miratuar sipas ligjit;

h) mbikëqyrjen e fondit pyjor kombëtar për parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme, të parashikuara me ligj;

i) monitorimin dhe inspektimin e situatës ndërtimore në të gjithë territorin, duke përfshirë zonat me rëndësi kombëtare, monumentet e kulturës, qendrat historike, parqet dhe zonat arkeologjike, zonat e mbrojtura natyrore dhe monumentet natyrore;

j) monitorimin e ecurisë së projekteve strategjike në zhvillim;

k) monitorimin e terminaleve të shkarkimit dhe depozitimit të lëndëve hidrokarbure;

- l) monitorimin e burimeve natyrore në sektorin mineral dhe hidrokarbur.
2. Çdo vit, Ministria e Mbrojtjes miraton orët e fluturimit për misionet e planifikuara apo të paplanifikuara, të ndara për çdo institucion shtetëror që ka kërkuar apo mund të kërkojë shërbim nga strukturat e mjeteve ajrore pa pilot.
3. Ministria e Mbrojtjes krijon kushtet e nevojshme për zhvillimin e operacioneve të mjeteve ajrore pa pilot, për drejtimin dhe bashkërendimin e punëve, në bashkëpunim me institucionet e përcaktuara në pikën 1, të kreut III, të këtij vendimi, për ofrimin e shërbimeve të kërkuara.
4. Koordinimi, drejtimi, komandimi, raportimi, shkëmbimi i informacionit me institucionet e tjera shtetërore dhe procedurat që ndiqen për angazhimin e strukturave të mjeteve ajrore pa pilot përcaktohen në dokumentin “Procedurat standarde të veprimit”, të miratuar nga ministri i Mbrojtjes.

V. BASHKËRENDIMI, PLANIFIKIMI DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE SHTETËRORE

1. Institucionet shtetërore të përmendura në kreun III bashkëpunojnë me Ministrinë e Mbrojtjes për përfitimin e shërbimit të kërkuar nga mjetet ajrore pa pilot.
2. Çdo institucion cakton një përfaqësues për të koordinuar punën me strukturat përgjegjëse në Ministrinë Mbrojtjes, me qëllim planifikimin dhe realizimin me sukses të operacionit, që ka lidhje me institucionet që ata përfaqësojnë dhe bashkërendojnë punën për zbatimin e këtyre planeve.
3. Çdo fillimviti kalendarik, institucionet shtetërore paraqesin kërkesë për orët e fluturimit që kërkojnë në dispozicion për mjetet ajrore pa pilot.
4. Ministria e Mbrojtjes dhe ministria përgjegjëse për infrastrukturën bëjnë të mundur sigurimin e fluturimit ajror për mjetet ajrore pa pilot.
5. Institucionet shtetërore bashkëveprojnë ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes për trajnimin dhe angazhimin, me qëllim përdorimin e burimeve në mënyrë racionale dhe rritjen e efektshmërisë operacionale të mjeteve ajrore pa pilot.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për hartimin e dokumentit “Procedurat standarde të veprimit”, për përdorimin operacional të mjeteve ajrore pa pilot, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet shtetërore të përmendura në kreun II për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama